

OSBE ndihmon Dokufest-in të fitoj popullaritet

Qyteti piktoresk i Prizrenit është vend i këndshëm për të qenë gjatë muajit gusht . Tani në vitin e tij të shtatë, Dokufesti – festivali më i madh kosovar i filmit dokumentar dhe atij të shkurtë – ishte më i famshëm se kurrë, duke joshur më shumë se 4000 adhurues të filmit dhe artistë nga rajoni dhe bota.

Veton Nurkollari, drejtor artistik i Dokufestit 2008, ka qenë shumë i zënë gjatë kësaj kohe. "Ishte e vështirë", thotë ai, duke iu referuar punës për përzgjedhjen e 139 filmave nga gjithsejtë 650 sa kanë konkurruar për dhjetë çmimet e para.

"Më tepër se 70 për qind e filmave kanë qenë të zhanrit dokumentar me tema nga më të ndryshmet, por që të gjitha shtjellonin problemet e përditshme jetësore", thotë ai. "Regjisorë nga 40 shtete kanë aplikuar për të marrë pjesë në festival".

Filmat e Dokufestit janë shfaqur nga 4 deri më 10 gusht në dy kinema të improvizuara verore në mbrëmje, kurse gjatë ditës adhuruesit e filmit janë mbledhur në kinemanë e qytetit pranë shtëpisë së kulturës.

Bëni filma, jo luftë

Prizrenasit, rreth 170,000 banorë, janë krenar për festivalin e tyre dhe mirëpritën mysafirët me bujarinë e tyre tradicionale pa marrë parasysh se nga ishin ata. "Është një kënaqësi e veçantë të jesh nikoqir i një ngjarjeje kulturore si kjo", thotë Bashkimi nga Prizreni.

Çdo ditë, më tepër se njëqind vullnetarë mblidheshin te 'Dokucity' për t'i shoqëruar mysafirët nëpër qytet. Besar Haxhia ishte njëri nga ta: "Dokufesti më bën të ndjehem gjallë", thotë ai. "Ne takuam mysafirë nga vende të ndryshme dhe ishte kënaqësi t'i takosh gjithë ata artistë". Afishe, fletushka dhe bluza me logo të Dokufestit dukeshin në çdo skaj të qytetit, duke mos harruar kafenetë e stërmbushura me adhurues të filmit, posaçërisht në mbrëmje.

Ky ishte festivali i parë për Teru Kuwayama, fotograf nga Nju Jorki i cili ka hapur një ekspozitë në Hamamin e qytetit me 20 fotografi nga Afganistani, Pakistani dhe Kashmiri. Në përgjithësi, ai nuk i adhuron festivalet sepse i duken shumë të mëdha dhe kolektive. Por, Dokufesti është një festival i ri, dhe sipas tij, sjell një energji të re.

Unë kalova çaste të mrekullueshme në Prizren dhe shpresoj të kthehem përsëri vitin që vjen. "Ishte kënaqësi të jesh në Kosovë, kësaj radhe jo për të mbuluar një konflikt por për një festival. Do të më bëhej qejfi sikur të gjithë reporterët që kanë mbuluar Kosovën gjatë konfliktit të kishin mundësi ta shijonin atmosferën gazmore këtu".

Edhe për Ilir Haxhin, regjisor filmi nga Shqipëria, ishte hera e parë: "Dokufesti është një projekt i shkëlqyeshëm", thotë ai, "si dhe një mundësi e mirë që regjisorët vendor ta tregojnë veten."

Filmi i tij i zhanrit të shkurtër 'Shkallët' shtjellon periudhën tranzitore në Shqipërinë e viteve 90ta, dhe flet për një njeri që i intereson vetëm paraja dhe ndërton një pallat me dymbëdhjetë kate jashtë çdo standardi. Në mënyrë paradoksale, ai kupton për problemet që u ka sjellë të tjerëve vetëm kur ai sëmurët dhe duhet të bartet në një barelë nëpër shkallët e ngushta që ai vetë i kishte ndërtuar.

Nga Kana në Prizren

Nurkollari konsideron festivalin e sivjetmë si sukses të madh. "Filmat që fituan çmime në festivale ndërkombëtare ishin në konkurrencë këtë vit", thotë ai. "Dy filma fitues në festivalin e Kanës u shfaqën këtu: 'Dashuritë e verbra,' një dokumentar nga regjisorin Sllovak Juraj Lehotskz, dhe filmi i zhanrit të shkurtër '2 Zogj' i regjisorit nga Islanda Runar Runarsson.

Nurkollari thotë se gjetja e donacioneve ka qene puna më e vështirë për të dhe ekipin e tij. "Energjinë tonë më të madhe ia kemi kushtuar mbledhjes së donacioneve. Tani po kërkojmë donatorë që do ta përkrahin Dokufestin gjatë gjithë vitit".

Ai mendon se ende duhet ofruar trajnime regjisorëve vendor sepse të mësohet se si dhe çka duhet bërë për të bërë një film - dhe si ai më së miri t'i shërbej publikut - janë çështje të rëndësishme. "Ne tani po përpiqemi ta kthejmë Dokufestin në një aktivitet gjithë-vjetor", thekson ai.

Dokufesti filloj në vitin 2002 me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Atëbotë, mezi u shfaqën 15 filma, kryesisht nga Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, të cilët konkurruan për tri çmime. Nurkollari me krenari thekson se ngritja e popullaritetit të festivalit është shenjë e suksesit.

Promovimi i demokracisë, të drejtat e njeriut

Çmimet për këtë vit u ndanë për: filmin më të mirë me metrazh të gjatë, dokumentari më i mirë ballkanik, filmi më i mirë i zhanrit të shkurtër, filmi më i mirë i animuar, filmi më i mirë për fëmijë dhe filmi më i pëlqyer nga audienca.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ndau për të dytën herë çmimin për të drejtat e njeriut, që këtë vit e fitojë filmi i regjisorit Gjerman Ben Kemps 'Beteja e lumit'. Ky film shtjellon përpjekjet e amerikanëve vendor nga Kalifornia veriore për të pasur të drejtën për peshkim dhe ruajtjen e kulturës së tyre. Në vitin 2006, regjisorja bullgare Adela Peeva fitoj çmimin e OSBE-së për filmin e saj që shtjellonte kuptimet e ndryshme të një kënge nga një vend ballkanik në tjetrin.

Filmi është një mjet i shkëlqyeshëm për edukim në demokraci, të drejta të njeriut dhe respekt për shumëllojshmëri", thotë Ida Nikolovska. zyrtare e

lartë në misionin e OSBE-së. "Përfitues të vetëm janë njerëzit, pa marrë parasysh përkatësin e tyre etnike," thotë ajo.

Meqë tani Dokufesti është bërë traditë, duhet shikuar çështja e institucionalizimit të tij të plotë. "Tani ka nevojë për më tepër se vetëm iniciativa vullnetare", thotë Nurkollari.

Ai sinqerisht shpreson se Ministria për kulturë, rini dhe sport, si dhe qeveria lokale ne Prizren do ta konsiderojnë mundësinë e marrjes së Dokufestit nën ombrellën e tyre. "Qëllimi ynë është që ta bëjmë Prizrenin një qendër filmi në regjion", përfundon Nurkollari.

Nga: Hasan Sopa

13 gusht 2008